



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 483/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur lidhur me apelin e Almira Bajramit nga Prizreni, kandidate për deputete nga subjekti politik Jedinstvena Goranska Partija (JGP), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotim me nr.0502A-01R, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.483/2019 e datës 08.11.2019, e paraqitur nga Almira Bajramit nga Prizreni, kandidate për deputete nga subjekti politik Jedinstvena Goranska Partija (JGP), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotim me nr.0502A-01R.

A r s y e t i m

Me datë 08.11.2019, kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik Jedinstvena Goranska Partija (JGP), Almira Bajramit, ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.483/2019, me të cilën kërkon që të rinumërohet vendvotimi me nr.0502A-01R, në fsh. Brod të Komunës së Dragashit, pasi që pas rinumërimit nga KQZ-ja në këtë vendvotim ka ndryshuar vetëm numri i votave tek unë, nga 24 në 4 gjë e cila është publikuar edhe në media ku akuzohem për keqpërdorim të votave nga ana e kandidatit, prandaj jam e detyruar që të kërkoj rinumërimin e kësaj qendre të votimit për të dëshmuar se nuk kam të bëjë asgjë me këtë dhe se e gjithë kjo është shpifje. Parashtruesja e apelit nuk ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e saj.

Në përgjigje në apel të datës 09.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se në bazë të Rregullës Zgjedhore 06/2013, procedura e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve nuk lejon asnjë Formular të Rezultateve të kaloj (procedohet si i rregullt) nëse nuk përputhen votat e subjekteve me votat e kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, atëherë Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim ose subjekti ka vota dhe kandidatët nuk kanë vota, Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon

në Auditim. Auditimi kontrollon të gjitha këto raste dhe në bazë të te gjeturave përgatit raportin dhe QNR, në bazë të raportit të Auditimit rekomandon KQZ-në, që vendotimet që kanë probleme të kësaj natyre të rinumërohen. Më tutje në përgjigje thekson se bazuar në nenin 5 paragrafi 7 i Rregullës së PZAP-së nr. 02/2015, dhe arsyet e lartcekura, konsiderojmë se ankesa është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e saj, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesen, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur gabime gjatë rinumërimit të votave, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete lidhur me atë se çfarë është pretenduar në apel sepse nga vet deklaratimet e ankuesit vërtetohet fakti se me rihapjen e kutisë, gjegjësisht me rinumërim janë konstatuar saktë se sa vota i ka pasur e njëjta në këtë vendvotim, dhe po ashtu rezultatet preliminare nuk janë rezultate të ankimueshme dhe gjatë procesit të rinumërimit nëse ka mospërputhje mund të përmirësohen siç ka vepruar QNR-ja në këtë rast, me rastin e rinumërimit.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Almira Bajrami e subjektit politik JGP, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë rinumërimit të votave.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.483/2019 më datën 09.11.2019

Kryesuesi i Panelit

Rrustem Thaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.